

NË EMËR TË POPULLIT

GYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti për Krime të rënda- Divizioni penal, si gjykatë penale e shkallës së parë, përmes kryetarit të trupit gjykues Aziz Shaqirit, me sekretaren juridike Kadrije Zymberi, si procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të pandehurit A.XH., për shkak të veprës penale falsifikimi i parasë nga neni 302 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm KPRK-s), të cilin sipas autorizimit e mbron Av...sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti i krimeve të Rënda PP.I.nr. 242/2014 të datës 19 nëntor të vitit 2014, të cilën e përfaqësoj prokurori i shtetit Afrim Shefkiu, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar, verbal dhe publik më 08 shtator të vitit 2016 mori dhe në prani të prokurorit të shtetit, të të pandehurit me mbrojtësin e tij të autorizuar si dhe të të dëmtuaritnga Gjilani, në të njëjtën ditë publikisht shpalli këtë,

A K T G J Y K I M

I. I pandehuri **A. XH.** nga babai ...dhe nëna..., me mbiemër të vajzërisë..., i lindur më ... në Gj., posedues i telefonit mobil..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, tregtar, me gjendje të mesme ekonomike, i pagjykuar dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale kundër tij, i tërhiqet vërejtja se është i detyruar që ta lajmëroj gjykatën për çdo ndërrim eventual të vendbanimit përkatësisht të vendqëndrimit të tij nën kërcënim të pasojave ligjore me lëshim të urdhër arrestit e nëse plotësohen kushtet ligjore edhe të letër rreshtimit,

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse më datën ..., në Gj., ka vënë në qarkullim duke besuar se është e vërtetë kartëmonedha e falsifikuar në vlerë prej ... Euro, me numër serik ..., me rastin e kryerjes së një obligimi ndaj K. K., për një borxh në shumën prej ... Euro, për një veturë të blerë nga një i afërm i tij ku ankuesi pasi ka pranuar këto të holla po të njëjtën ditë ka shkuar në ... BANK për t'i deponuar në xhiro-llogarinë e tij dhe nga zyrtarja e kësaj bankës është vërtetuar se e njëjta është e falsifikuar, e njëjta kartëmonedhë i konfiskohet dhe rasti lajmërohet në Polici të Kosovës,

- me çka ka kryer veprë penale **falsifikimi i parasë** nga neni 302 paragrafi 3 të KPRK-s.

Gjykata në bazë të dispozitave të cituara, nenit 4, 7, 21, 41, 43, 46, 73,74, 75 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe 1.3 të KPRK-s si dhe nenit 365 të Kodit të procedurës penale (në tekstin e mëtutjeshëm KPP-s), të pandehurit

I S H Q I P T O N

-Dënim me gjobë në shumën prej katërqind (400) Euro, të cilën shumë detyrohet ta përmbush në afat prej dy muajve në këste të barabarta, duke filluar nga dita e pranimit të aktgjykimit të plotfuqishëm lidhur me këtë çështje penale, në të kundërtën dënimi i tillë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëzetë (20)ditëve, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

II. Të pandehurit në fjalë në kuptim të nenit 69 dhe 302 paragrafi 6 të KPRK-s i shqiptohet **dënimi plotësues** – konfiskimi i kartëmonedhës së falsifikuar në poenë prej ...

Euro, me numër serik ..., e cila do të shkatërrohet nga komisioni përkatës i formuar nga kryetari i kësaj gjykate, duke u konstatuar me procesverbal nga ana e shërbimit për ekzekutimin e sanksioneve penale të kësaj gjykate.

III. DETYROHET i pandehuri në fjalë që kësaj gjykate t'ia paguaj shpenzimet e procedurës penale përkitazi me paushallin gjyqësor në shumën prej dyzetë (40) Euro, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Organi i ndjekjes penale kundër të pandehurit në fjalë ka paraqitur aktakuzën lëndore, për shkak të dyshimit të bazuar mirë, se i njëjti ka kryer veprën penale lëndore nga neni 302 paragrafi 2 të KPRK-s.

Përfaqësuesi i aktakuzës gjatë seancës së shqyrtimit fillestar ka bërë ndryshimin e përshkrimit faktik, ashtu që pas fjalëve “ në qarkull “ shtohen fjalët “ duke besuar se është e vërtetë “, por edhe kualifikimin juridik të veprës penale e ndryshon ashtu që në vend të paragrafit “2” duhet të jetë paragrafi “ 3 “. Pjesa tjetër mbetet e pandryshuar.

Kryetari i trupit gjykues pas pranimit të lëndës duke respektuar kronologjinë e lëndëve të pranuara, ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor duke ftuar palët, mbrojtësin e të pandehurit por edhe palën e dëmtuar.

I pandehuri pasi që është njoftuar me të drejtat e tij në kuptim të nenit 246 të KPP-s, me theks të veçantë edhe për pasojat e pranimit të fajësisë por edhe favoret e pranimit të fajësisë, me vetëdije të plotë dhe vullnet të lirë pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij shprehimisht ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale të përmirësuar nga ana e prokurorit të shtetit, e pasi që këtë nuk e kanë kundërshtuar as mbrojtësi i të pandehurit e as prokurori i shtetit, kryetari i trupit gjykues me aktvendim procedural ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, duke vërtetuar se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 248 paragrafi 1 të KPP-s.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë akuzës së përmirësuar dhe veprës penale të rikualifikuar, duke i propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtor dhe dënoj sipas Kodit Penal, e me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit t'i ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

I dëmtuari K. K. ka deklaruar se me A. ka raporte të shkëlqyeshme shoqërore dhe ka bindje të lartë se vërtetë i njëjti me rastin e dorëzimit të shumës prej ... Euro, nuk e ka ditur se kartëmonedha në apoën prej ... Euro është e falsifikuar, por ka menduar se është e vërtetë. Përkundër kësaj i njëjti ma ka kompensuar dëmin prej ... Eurove, kështu që personalisht nuk ka kurrfarë kërkesë pasurore ndaj tij.

Mbrojtësi i të pandehurit ka deklaruar se i mbrojturi i tij me vetëdije të plotë dhe vullnet të lirë ka pranuar fajësinë për veprën penale lëndore, tani të përmirësuar dhe të rikualifikuar, se i njëjti asnjëherë nuk ka qenë i gjykuar dhe nuk zhvillohet ndonjë procedurë penale kundër tij, se vërtetë ka besuar se kartëmonedha në fjalë është e vërtetë por ka rezultuar se është e falsifikuar, e për shkak të kësaj edhe ia ka kompensuar dëmin në tërësi palës së dëmtuar. Duke i pasur parasysh këto rrethana veçanërisht lehtësuese gjykatës i ka propozuar që të mbrojturit të tij t'ia shqiptoj një dënim të arsyeshëm me bindje të plotë se me te do të arrihet qëllimi i plotë i dënimit sipas dispozitave ligjore.

I pandehuri e ka pranuar mbrojtjen e mbrojtësit të tij në tërësi. Kësi rasti asnjëherë më parë nuk i ka ndodhur dhe se me biznesin të cilin e ushtron e mban familje, duke u zotuar

se në të ardhmen verifikimin e parave do ta bëjë në bankë përmes detektorëve të tyre. Dëmin në tërësi ia ka kompensuar palës së dëmtuare edhe pse nuk e ka ditur se paraja është e falsifikuar, duke besuar se është e vërtetë.

Gjykata për mos me e mbështet aktgjykimin vetëm në pranimin e fajësisë së të pandehurit ka vendos që të vlerësoj në kuptim të nenit 361 të KPP-s edhe provat tjera në shkresa të lëndës, duke vërtetuar gjendjen faktike sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga gjendja faktike e vërtetuar rezultojnë elementet objektive të veprës penale, pasi që kartëmonedha lëndore e falsifikuar është lëshuar në qarkullim edhe se i pandehuri ka besuar se e njëjta është e vërtetë, por edhe elementi subjektiv i cili konsiston në dashje eventuale, pasi që vërtetë ka besuar se kartëmonedha lëndore është e vërtetë, por pasi që ka pranuar një shumë të lart nga personi përkatës, si biznesmen ka pasur mundësi që ta bëjë verifikimin e parave të tilla, nga të cilat ia ka paguar borxhin palës së dëmtuar, e në mesin e shumës prej ... Eurove ka qenë edhe kartëmonedha në apoena prej ... Euro e cila ka rezultuar përmes detektorit se është e falsifikuar. Po ashtu gjykata ka vërtetuar se i pandehuri është penalisht përgjegjës për veprën penale lëndore, pasi që kemi lidhjen psikike të të pandehurit në fjalë me veprën penale, dhe se i pandehuri e ka kuptuar rëndësinë e veprimit të tij tani të vërtetuar se është kriminal dhe se ka mundur që t'i shmanget kryerjes së kësaj vepre penale, duke ndërmarr veprimet e lartcekura – duke vërtetuar vërtetësinë e kartëmonedhës lëndore me detektorë.

Gjykata duke pasur parasysh gjendjen faktike të vërtetuar ka vërtetuar se në veprimet e të pandehurit qëndrojnë të gjitha tiparet e veprës penale të falsifikimit të parasë nga neni 302 paragrafi 3 të KPRK-s, andaj edhe ka vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes ka pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73, 74 si dhe nenit 75 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2. dhe 1.3 të KPRK-s edhe atë : si rrethana lehtësuese ka gjetur pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pendimin e sinqertë pore dhe premtimin serioz se në të ardhmen do t'i shmanget kryerjes së veprave të tilla duke u zotuar se verifikimin e parave do ta bëjë me detektorë, se dëmin ndaj të dëmtuarit e ka përmbushur menjëherë porsa është lajmëruar nga pala e dëmtuar se një kartëmonedhë prej ... Euro është e falsifikuar, se është i pagjykuar dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale ndaj tij, ndërsa rrethana rënduese nuk ka gjetur.

Andaj, duke pasur parasysh gjendjen faktike të vërtetuar por edhe rrethanat lehtësuese të lartcekura, në kuptim të nenit nenin 75 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe 1,3 të KPRK-s gjykata është bindur se edhe me dënimin me gjobë të shqiptuar si në dispozitiv, mund të arrihet qëllimi i plotë i dënimit edhe atë me lartësinë e tillë – në kuptim të nenit 41 të KPRK-s, duke parandaluar të pandehurin në fjalë që në të ardhmen mos të kryej vepra penale por dhe se do të disiplinohen edhe qytetarët tjerë potencial që mos të kryejnë vepra të natyrës së njëjtë apo të ngjashme.

Në kuptim të nenit 69 dhe nenit 302 paragrafi 6 të KPRK-s të pandehurit i është shqiptuar edhe dënimi plotësues si në dispozitiv.

Në kuptim të nenit 368 të KPP-s palët pas shpalljes së aktgjykimit janë njoftuar me të drejtën në ankesë.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës penale përkitazi me paushallin gjyqësor vendosi në kuptim të nenit 450 lidhur me nenin 453 të KPP.

Nga të cekurat e më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Departamenti i Krimeve të Rënda
Divizioni Penal PKR.nr. 237/2014,më dt. 08 shtator të vitit 2016**

**Sekretarja juridike,
gjkues ,
Kadrije Zymeri**

**Kryetari i trupit

Aziz Shaqiri**

Udhëzim për mjetin juridik: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimi të ekzemplarit të këtij aktgjykimi. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj Gjykate.